



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Qershor, 2019

SBASHK në një takim me rëndësi të sindikatave të arsimit të Evropës **Në Qipro sindikalistët debatojnë për integrimin e refugjatëve në arsim**



Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës vazhdon me aktivitetet dhe takimet e shumta kudo në qytete të kontinentit të vjetër. Një aktivitet i veçantë ishte edhe ai në Larnaka të Qipros e që kishte për qëllim përgatitjen e sindikatave anëtare për një qasje sa më të suksesshme për të promovuar integrimin efektiv të emigrantëve dhe refugjatëve në arsim në vendet nga vijnë këto sindikata. Pjesë e këtij aktiviteti të rëndësishëm ishte edhe SBASHK-u. Përfaqësuesi i SBASHK-ut në këtë Konferencë „z.Ymer Ymeri ka zhvilluar shumë takime me përfaqësues të sindikatave tjera me qëllim që të shtohet bashkëpunimi sindikal dhe të formësohen idetë për angazhimet në shërbim të anëtarësisë...(Faqe 5)

Vazhdohet me traditën e mirë

Në bregdetin shqiptar 400 anëtarë të SBASHK-ut



Në verën 2019 Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, pasi ka analizuar në përpikëri mundësitë buxhetore, ka vendosur që në çdo 60 anëtarë të dërgojë një pushues ...(faqe 5)

Kënga dhe humori i lehtë bashkë me valët e detit shqiptar



Pushuesit shprehen se çdo gjë është në nivel të lartë

Duke vazhduar traditën e mi...(Faqe 6)



Intervistë me mësimdhënësen Marigona Bytyqi

Të jesh mësimdhënës nuk është e lehtë. Ky profesion kaq human kërkon një punë të vazhduar...(Faqe 3)

Interesim i madh edhe për mediet dhe rolin e tyre



Trajnimet e licencuara nga SBASHK-u "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" dhe "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar",...(faqe 7)



Editorial

Me pishtarët e dijes



Të gjithë e thoshin se ky vit shkollor ka qenë plot me sfida dhe mjaft i vështirë. Ata kishin ardhur në bregdetin shqiptar të përzgjedhur prej kolegëve të tyre nga shkollat dhe njësitë akademike. Shpreheshin plot respekt dhe krenari për angazhimet dhe qëndrimin dinjitoz në përballje me sfidat. Fillonin bisedat në mënyrë spontane dhe pastaj me mirësi kërkonin të fotografoheshim bashkë.

Është kjo ndjenjë e mirë kur njerëzit të respektojnë dhe ta vlerësojnë angazhimin. Është mirë kur bisedat janë spontane, të lehta dhe përmbajtjesore.

Bisedonim edhe për sfidat, për kurrikulin, tekstet shkollore, trajnimet, ligjet dhe madje edhe këmbeshin ide e dije në përpjekjet e radhës për arsim edhe më të mirë.

Anëtarët e SBASHK-ut edhe gjatë pushimeve në bregdetin shqiptar një pjesë të kohës e kalonin duke bashkëbiseduar e duke dhënë ide për angazhimet e radhës.

Kjo është mirë dhe kështu unik e duke i besuar njëri-tjetrit do të shënojmë suksese e arritje të reja. Ne jemi bashkë e në SBASHK dhe kështu do të vazhdojmë gjatë gjithë viteve e dekadave.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësen Marigona Bytyqi



Arsimimi sot:

Kush është Marigona Bytyqi?

Marigona:

Marigonë Bytyqi jeton në fshatin Semetisht, komuna e Suharekës.

Shkollimim e mesem e përfundoj në shkollën e mesme të mjekësisë “Luciano Motroni “ në Prizren, ku në vitin 2005 e mbarojë këtë nivel të shkollimit.

Po në atë vitë i filloj studimet në departamentin e Sociologjisë, të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës ” Hasan Prishtina” në Prishtinë. Ku në 2009 e mori titullin Bachelor i Sociologjisë. Ku në shtator të 2009 –ës filloj punën si mesimdhënëse e lëndës së Edukatës qytetare në shkollën e mesme të ulët “ Vasa P. Shkodrani ” në Leshan të Suharekës ku ende vazhdon të punoj. Ndërsa studimet e nivelit masteri i përfundoj në vitin 2018. Dhe prej fillimit të punës në arsim është bashkuar anëtarësisë së SBASHK-ut.

Arsimimi sot:

Sa është i vështirë profesioni i mësimdhënëses sot ?

Marigona:

Të jesh mësimdhënëse nuk është e lehtë. Ky profesion kaq human kërkon një punë të vazhdueshme dhe shumë të lodhshme. Mirëpo si çdo gjë tjetër në jetë asgjë nuk është e pamundur, kur puna dhe vullneti janë të mëdha.

Por në një shoqëri demokratike e të hapur puna e mësuesit është e vështirë dhe kërkon përgatitje të lartë profesionale. Rrugët për marrjen e informacionit janë të shumta, problemi qëndron te zgjedhja dhe seleksionimi i informacionit shkencor dhe artistik. Përpara viteve '90 kjo punë ishte më e thjeshtë dhe më pak e lodhshme, sepse nxënësi kishte vetëm dy burime informacioni: librin dhe mësuesin. Sot, burimi i

informacionit për mësuesin dhe nxënësin është i pafundmë, madje nxënësi ndonjëherë është disa hapa përpara mësuesit. Por mësuesi duhet të përpunon, diferencon dhe drejton punën që duhet të bëjë nxënësi me teknologjinë dhe librin. të cilit nuk do t'i humbasë rolin dhe rëndësia. Të gjithë mësuesit, por kryesisht ne të rinjtë, duhet të jemi në pararojë për njohjen e teknologjisë dhe informacionit, për të organizuar veprimtari cilësore si; konkurse, lojëra, ekspozita etj. Puna e mësuesit është e vështirë. Që të ridimensionohet figura e mësuesit duhet të punuar në dy drejtime; nga shteti dhe nga vetë individi.

Më vjen në mendje thënia e William A. Ward:”Mësuesi mediokër flet, mësuesi i mirë shpjegon, mësuesi superior demonstroi, Mësuesi i madh inspiron”.Inspirimi nga mësuesi dhe përkrahja nga shteti do të bëjnë të mundur rikthimin e vlerësimit maksimal ndaj mësuesit. Mësuesin e mirë, pasionant e do shkolla, prindërit, nxënësit dhe shoqëri në përgjithësi.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHK-ut ?

Marigona:

SBASHK ka aktivitete të shumta dhe të larmishme. Por do veçoja përpjekjet për Ligjin e Statusit të Punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta, Kontratën kolektive, që nuk po zbatohet mjaftueshëm, mirëpo me angazhim më të madh të SBASHK shpresojmë të zbatohet në tërësi. Pastaj kundërshtimi i Ligjit të pagave, duke i mbrojtur me përkushtim të drejtat e mësimdhënësve etj.

Arsimimi sot:

Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta ?

Marigona:

SBASHK-ut i sugjeroj që të insistoni që kontrata kolektive të zbatohet në tërësi, gjithashtu të ngris zërin edhe më shumë për kushtet në të cilat punojnë punëtorët e arsimit në Kosovë.

Arsimimi sot:

Çka do të veçonit nga përvoja e juaj si udhëheqese e grupeve të pushuesve në bregdetin shqiptar ?

Marigona:

Ishte privilegj dhe nderë për mua të jem pjesë e një komisioni me shumë përgjegjësi por edhe kënaqësi. Unë në këtë komision isha udhëheqëse për komunën e Skenderaj, Fushë Kosovës, Obiliqit, Lipjanit dhe nga Universitetet.. Me të vërtetë çdo gjë ka qenë e detajuar, duke u nisur nga agjenda e udhëtimit, akomodimit në autobusë, arritjes, akomodimit në dhoma , agjenda e ushqimit. Ishte kënaqësi për mua dhe privilegj që të kontribuoj për anëtarësinë e SBASHK-ut. Edhe pushuesit nga komunat e lart cekura janë ndarë shumë të kënaqur me gjithë shërbimet e ofruara si nga ana e SBASHK-ut, po ashtu edhe nga Kompleksi Hotelier “Bonita”. Me gjithë forcat jam përkushtuar që cdo detaj të shkojë sipas agjendës së përgatitur nga SBASHK-u dhe më të vërtetë ia dolëm. Ishte për mrekulli çdo detaj i paraqitur. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ishte në çdo moment prezent, duke dhënë kontributin e tij maksimal për çdo pyetje që shtronin anëtarët- pushuesit, në takimet që zhvillonim aty për aty. Është mirë kur je në mesin e kolegëve dhe stafit të SBASHK-ut aq modest dhe shumë përkrahës. FALEMINDERIT që ma besuat këtë detyrë.

Arsimimi sot:

Cila është vlera e këtij aktiviteti sipas jush?

Marigona:

Vlera e këtij aktiviteti mund të themi se është njeri ndër aktivitetet më të bukura dhe shumë i rëndësishëm, për anëtarët e SBASHK _ut. Sepse me

këtë SBASHK-u për cdo vitë iu mundëson anëtareve të saj të kenë një pushim me të gjitha kushtet duke filluar nga nisja qëndrimi në pushim dhe kthimi.. ky është një aktivitet i cilen e ruan SBASHK-u.

Dhe që iu mundëson këtë atraktivitet atyre anëtareve që në mesin e të cilëve ka që për herë të parë në jetën e tyre kanë prekur bregdetin, ku gjatë qëndrimit derisa po merrja përshtypjet më ra të dëgjoj një zë të lart nga një anëtar duke thënë: ” kush ka sindikatë botën ka" kjo sepse po e shijonin pushimin si dhe plotë urime të tjera... vërtetë këtë aktivitet e cmoj dhe uroj të mos ndalet sa të këtë SBASHK.

Arsimimi sot:

Çka te shtyri te antaresoheni në SBASHK?

Marigona:

Punëtorët e arsimit duhet të jenë të mbrojtur në mënyrë që të mos u cenohen të drejtat ligjore. Këtë mbrojtje është duke e bërë SBASHK-u. Po ashtu kjo sindikatë ka treguar gjithmonë unitet dhe përkushtim në realizimin e kërkesave të punëtorëve të arsimit e të kulturës. Kjo ka bërë që edhe unë dhe shumë punëtorë të tjerë të arsimit të anëtarësohemi në SBASHK.

Arsimimi sot:

A keni diçka për të shtuar ?

Marigona:

Shpresoj që SBASHK do ta vazhdojë angazhimin e tij në mbrojtjen e të drejtave ligjore të punëtorëve të arsimit si dhe të krijojë kushte edhe më të favorshme për ta.

Gjatë muajit

Vazhdohet me traditën e mirë

Në bregdetin shqiptar 400 anëtarë të SBASHK-ut



Në verën 2019 Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, pasi ka analizuar në përpikëri mundësitë buxhetore, ka vendosur që në çdo 60 anëtarë të dërgojë një pushues në bregdetin shqiptar. Përzgjedhjen e pushuesve e kanë bërë shoqatat sindikale në çerdhe, shkolla fillore e të mesme, në njësitë akademike të universiteteve dhe të institucioneve të kulturës.

SBASHK-u vazhdon me traditën duke vlerësuar e çmuar lart përkushtimin e punëtorëve të arsimit të

Kosovës në edukimin e arsimimin e brezave nëpër vite e dekada.

Me qëllim që organizimi të jetë sa më i mirë i pushimeve dhe aktiviteteve sindikale atje të 400 pushuesit janë të ndarë në 4 grupe. Grupi i parë me pushuesit nga Podujeva, Prishtina, Skenderaj, UP-ja, Qendra e studentëve, Fushë Kosova, Obiliqi dhe institucionet e kulturës kanë nisur këtë traditë të mirë të mërkurën, më 26 qershor, për të vazhduar ky aktivitet me pushuesit nga komunat tjera dhe atë: më 28 qershor Kaçaniku, Hani i Elezit, Ferizaj, Shterpcë, Shtime, Dragashi, Kamenica, Gjilani, Vitia, Kllokoti, Novobërda. Në grupin e tretë, më 1 korrik buzë valëve të detit shqiptar do të jenë anëtarët e SBASHK-ut nga Klina, Burimi

(Istogu), Peja, Deçani, Juniku, Mitrovica, Vushtrria, Drenasi dhe Leposaviqi ndërsa ky aktivitet do të përfundoi këtë vit me grupin e katërt, të cilin e përbëjnë anëtarët e SBASHK-ut nga Malisheva, Rahoveci, Gjakova, Theranda (Suhareka), Prizreni dhe Mamusha.

SBASHK në një takim me rëndësi të sindikatave të arsimit të Evropës

Në Qipro sindikalistët debatojnë për integrimin e refugjatëve në arsim



Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës vazhdon me aktivitetet dhe takimet e shumta kudo në qytete të kontinentit të vjetër. Një aktivitet i veçantë ishte edhe ai në Larnaka të Qipros e që kishte për qëllim përgatitjen e sindikatave anëtare për një qasje sa më të suksesshme për të promovuar integrimin efektiv të emigrantëve dhe refugjatëve në arsim në vendet nga vijnë këto sindikata.



Pjesë e këtij aktiviteti të rëndësishëm ishte edhe SBASHK-u. Përfaqësuesi i SBASHK-ut në këtë Konferencë „Z.Ymer Ymeri ka zhvilluar shumë takime me përfaqësues të sindikatave tjera me qëllim që të shtohet bashkëpunimi sindikal dhe të formësohen idetë për angazhimet në shërbim të anëtarësisë.



Këtë Konferencë e ka kryesuar drejtorja e ETUCE-s, znj. Suzan Flocken , e cila ka përshëndet pjesëmarrësit dhe pastaj edhe ka kujtuar rolin që kanë sindikatat e mësimdhënësve në integrimin sa më të plotë të fëmijëve të emigrantëve e refugjatëve në sistemin arsimor te vendit në të cilin kanë gjetur mbështetje dhe strehim.

Përfaqësuesi i SBASHK-ut ka vlerësuar lartë punimet e kësaj Konference duke treguar gjatë kësaj Konference pjesëmarrësit kanë marrë njohuri të

shumta për mes trajnimeve për të qenë sa më të përgatitur përball sfidave të kohës në të cilën po ndodhin shumë konflikte dhe me këtë edhe shtohet numri i refugjatëve, të cilët ikin nga vendet e tyre nga shkak i rrezikut të jetës nga veprimet luftarake në vendlindjen e tyre.



Përfaqësuesi i SBASHK-ut, krahas kontributit në Konferencë, ka zhvilluar edhe takime të shumta me përfaqësues të Sindikatave nga shtete të ndryshme duke shprehur gatishmërinë për forcimin e bashkëpunimit me to.

Kënga dhe humori i lehtë bashkë me valët e detit shqiptar

Pushuesit shprehen se çdo gjë është në nivel të lartë



Duke vazhduar traditën e mirë edhe këtë vit SBASHK-u po dërgon 400 anëtarë nga e tërë Kosova për pushime në bregdetin shqiptar.

Ky aktivitet ka nisur këtë vit më 26 qershor me 100 pushuesit e parë nga Podujeva, Prishtina, Universitetet , institucionet e kulturës, Qendra e studentëve, Skenderaj, Fushë Kosova, Obliqi, Lipjani dhe Zveçani. Edhe pse vinin nga komuna e institucione të ndryshme këta pushues kanë krijuar një atmosferë të mrekullueshme dhe me sjelljet e tyre të kulturuara kanë përfaqësuar në mënyrë të denjë figurën e punëtorit të arsimit.



Dy ditë më vonë, gjegjësisht më 28 qershor, pjesë e këtij aktiviteti rekreativ janë bërë edhe të përzgjedhurit nga shkollat e Kaçanikut, Hanit të Elezit, Ferizajt, Shtimes, Shterpcës, Dragashit, Kamenicës, Gjilanit, Vitisë dhe Klllokotit .Edhe këta 100 pushues janë bërë pjesë e atmosferës së qetë dhe ia kanë shtuar gjallërinë këngës , humorit të lehtë dhe valles. Me këto dy grupe pushuesish kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka zhvilluar takime të ndara duke bashkëbiseduar me shumë prej tyre duke u përgjigjur në shumë pyetje. Pushuesit janë ndjerë mirë që edhe kryetari Jasharaj është me ta dhe kanë bërë shumë foto për të kujtuar këto momente të bukura të pushimit në bregdetin shqiptar.



Një moment i veçantë ishte mbrëmja e 29 qershorit kur anëtarë të Ansambllit Autokton "Rugova" në shenjë respekti për punën e madhe të punëtorëve të arsimit nëpër vite e dekada kanë marrë një aktivitet vullnetar duke vizituar pushuesit dhe duke shpalosur fragmente nga vallet, lojërat e vjetra popullore dhe traditat e bjeshkëve të Kelmendit. Paraqitja e Ansambllit ka gjallëruar atmosferën dhe ka zgjuar kërshërinë edhe të pushueseve nga vende të ndryshme të Evropës, të cilët kanë bërë shumë foto e xhirime nga programi i këtij Ansambli që ruan vallen e bukur shqipe me vite e dekada. Moment i veçantë i kësaj mbrëmjeje artistike ishte vallëzimi i pjesës më të madhe të pushuesve bashkë me anëtarë të Ansambllit.

Në kuadër të këtij programi artistik kryetari i SBASHK-ut ka përgëzuar pushuesit për qëndrimin dhe përfaqësimin e dinjitetshëm të SBASHK-ut këtu. Po ashtu ai i ka përgëzuar gjithë punëtorët e arsimit në Kosovë për unitetin e treguar vazhdimisht. Në vazhdim të fjalës së tij kryetari i SBASHK-ut duke folur për këtë traditë të mirë ka përmendur punën e angazhimin e madh që ka bërë edhe këtë vit komisioni për përgatitjen dhe organizimin e pushimeve i udhëhequr nga Ymer Ymeri.

Në shtator rifillojnë trajnimet nëpër komuna

Interesim i madh edhe për mediet dhe rolin e tyre



Trajnimet e licencuara nga SBASHK-u "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut

Atmosfera e bukur me këngë e valle e humor të lehtë ka zgjatur me orë të tëra duke shoqëruar ritmin e qetë të valëve të detit shqiptar.



Më 1 korrik pushuesit e grupit të parë janë përshëndetur me kolegët e tyre të grupit të dytë dhe janë përgatitur për t'u kthyer në mënyrë që të përgatiteshin ambientet e pushimit për grupin e tretë. Janë këta pushues anëtarë të SBASHK-ut nga Klina, Burimi (Istogu), Peja, Deçani, Juniku, Mitrovica, Vushtrria, Drenasi dhe Leposaviqi.

Pushimet e këtij viti do të përmbyllën me grupin e katërt prej 100 pushuesve nga Malisheva, Rahoveci, Gjakova, Theranda(Suhareka), Prizreni dhe Mamusha.

Përshtypjet shumë nga pushuesit i kanë lënë e do t'i lënë në ditarët e pushimeve dhe shumë nga to do t'i botojmë në web faqen e SBASHK-ut, por edhe në gazetën tonë "Arsimimi sot" bashkë me shumë foto sepse një foto flet më shumë se dhjetëra fjalë.

social" dhe "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar", " Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" dhe "Edukimi media dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" janë zhvilluar në disa prej komunave të Kosovës.

Një trajnim i veçantë është "Edukimi media dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik". Rëndësia e këtij trajnimi është se pjesëmarrësit pajisen me njohuri për mediet dhe se kështu përgatiten që në atë

ardhmen e afërt të jenë bartës të lëndës së mësimi zgjedhor pikërisht për mediet me idenë që kjo të bëhet në gjimnaze edhe lëndë e rregullt mësimore.



Në fillimet e këtij trajnimi janë përfshirë 60 anëtarë të SBASHK-ut nga Gjilani e Podujeva. Ky trajnim mbahet nga profesorët e Departamentit të Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës . Ligjëruesit në këtë trajnim kanë ngritur çështje me rëndësi në formë të pyetjeve që lidheshin me mediet, komunikimin,

standardet etike e profesionale në gazetari, lajmi i rrem dhe shumë çështje të tjera të ndërlidhura me gazetarinë.



Do theksuar se ky trajnim është përcjellë me interesim të madh nga mësime të këtyre 4 dy komunave dhe janë shtuar kërkesat për një trajnim të tillë edhe në shumë komuna tjera të shtetit tonë.

Në SBASHK planifikojnë që këtë trajnim ta organizojnë edhe për anëtarët e Këshillit Drejtues dhe për kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM dhe të Universitetit me qëllim që ata të përgatiten për qasje të duhur ndaj medieve dhe të marrin njohuri për komunikim të suksesshëm me të tjerët.

Presim bashkëpunimin tuaj me gazetën tonë “Arsimimi sot”

Të shkruajmë për aktivitete dhe arritjet në shkollat dhe komunat tona



Në institucionet arsimore të Kosovës ka shumë punëtorë të devotshëm, të cilët me punë e përkushtim kanë shënuar arritje të shumta në procesin mësimor, por edhe në aktivitetet edukative e kulturore.

Në shkollat tona ka shumë mësime të cilët dallohen në artin pamor, në pikturë e skulpturë. Ka edhe kolegë poetë, mjeshtër të muzikës. Ka edhe nga ata që dallohen për risitë në procesin edukativ e mësimor.

Po ashtu ka shumë nga institucionet arsimore që kanë rregulluar për mrekulli ambientet e jashtme . Këto duhet promovuar e duhet bërë të njohura për lexuesit gazetës sonë. Të nderuar, gazeta jonë shpërndahet në më shumë se 16.000 adresa, Atë ua dërgojmë edhe institucioneve të ndryshme dhe duke bashkëpunuar ju me ne e duke na dërguar shkrime për arritjet dhe aktivitetet ato behën të ditura për shumë kë dhe kështu japim shembuj konkret se në shkollat tona punohet me përkushtim se dhe kemi shumë mësime të zellshëm dhe shumë nxënës të mirë e të talentuar.

Na shkruani duke na dërguar edhe fotografi që ilustrojnë shkrimet tuaja dhe ne do t'i botojmë. Na shkruani sepse “Arsimimi sot” është gazeta jonë. Është zëri i gjithë anëtarësisë kudo janë ata.

Bashkërisht mund ta bëjmë edhe më përmbajtësore gazetën tonë.

Llogaria e Pagës

Veç



- ✓ Mirëmbajtja e llogarisë
- ✓ Mobile Banking & E-Banking
- ✓ Njoftim nga BKT Mobile
- ✓ Lëshimi i parë i Kartës së Kreditit
- ✓ Lëshimi i parë i Kartës së Debitit
- ✓ Tërheqje në ATM të BKT-së Kosovë & Shqipëri
- ✓ Blerje në POS dhe Online

Pa komision shtesë!



020 800 800 | www.bkt-ks.com

Ne jemi gjithmonë këtu!